



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2020

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.108/2014,
“PËR POLICINË E SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 29, të nenit 6, shtohet pika 29/1, me këtë përmbajtje:

“29/1. “Procedim policor”, është tërësia e veprimtarisë gjurmuese e hetimore, si dhe çdo veprim apo masë e Policisë së Shtetit, parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të parandalimit të kryerjes së veprave penale, hetimit penal dhe ruajtjes së rendit e të sigurisë publike.”.

Neni 2

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Komiteti Kombëtar i Politikave për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit të Organizuar

1. Pranë ministrit përgjegjës për çështjet e sigurisë e rendit publik dhe nën drejtimin e tij krijohet dhe funksionon Komiteti Kombëtar i Politikave për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit të Organizuar.

2. Komiteti Kombëtar i Politikave për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit të Organizuar ka për objekt të veprimtarisë së tij hartimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjive dhe të planit të masave për parandalimin e krimit të organizuar.
3. Komiteti kryesohet nga ministri i Brendshëm dhe ka në përbërje ministrin e Drejtësisë, ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Prokurorin e Përgjithshëm, drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit, drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtorin e agjencisë përgjegjëse për luftën kundër terrorizmit dhe drejtorin e agjencisë përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave.
4. Komiteti harton e publikon të dhëna mbi studime që identifikojnë shkaqet bazë të krimit, kontrole sigurie, tendencat dhe kërcënimet e krimit të organizuar, rrethanat në të cilat vepron krimi i organizuar, grupet profesionale dhe teknologjitë e përfshira në kriminalitet, duke përfshirë palët shtetërore dhe joshtetërore, efektivitetin e efikasitetin e ligjeve, të politikave dhe të planeve të masave për të parandaluar e për të ulur krimin e organizuar, përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare.
5. Komiteti mblidhet, të paktën, 1 (një) herë në 3 (tre) muaj dhe i paraqet raport periodik mujor Këshillit të Ministrave. Komiteti, me propozimin e ministrit të Brendshëm, miraton rregulla të hollësishme për funksionimin e tij.”.

Neni 3

Në nenin 84, pas fjalës “... policore ...” shtohen fjalët “... dhe jopolicore ...”.

Neni 4

Neni 131 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 131 Masa të veçanta

1. Gjatë veprimtarisë informative-gjurmuese ose të një procedimi policor, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e veprave penale të autorëve të tyre, Policia e Shtetit përdor këto masa të veçanta:
 - a) Përgjimin ambiental të bisedave të personave në ambiente publike, si dhe në mjete të transportit publik;
 - b) Përdorimin e pajisjeve teknike për fotografimin, filmimin ose me video të personave në vende publike dhe përdorimin e pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes;

- c) Përgjimin e bisedave telefonike ose telekomunikimeve, që rregullohet me ligj të veçantë;
 - ç) Mbikëqyrjen e fshehtë të personave të dyshuar për kryerjen e veprimtarive kriminale.
2. Përdorimi i masave të veçanta, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, bëhet me vendim të miratuar nga titullarët e strukturave të policisë, në nivel drejtorie qendrore e vendore.
 3. Afati i përdorimit të masave të veçanta, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, nuk mund t’i kalojë 3 (tre) muaj. Kur këto masa përdoren për kryerjen e veprimtarisë informative-gjurmuese ose gjatë procedimit policor, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e krimit të organizuar apo të krimeve të rënda, me kërkesë të drejtuesit të strukturës policore përkatëse, afati i përdorimit mund të zgjatet vetëm 1 (një) herë me 3 (tre) muaj të tjerë.
 4. Rregullat dhe procedurat që zbatohen për përdorimin e masave të veçanta, të parashikuara në shkronjat “a” e “b”, të pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
 5. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mund të kontrollojnë, në çdo kohë, zbatimin e rregullave dhe të procedurave të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni.”.

Neni 5

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen ministri i Brendshëm, Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar që të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të dispozitës së ndryshuar me këtë ligj, brenda 3 (tre) muajve nga miratimi i tij.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI